



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received / Delivered	21-04	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SPINSHICK	2306/2022		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.237/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.237/2022 të datës 16/03/2022 të parashtruar nga ankuesi kundër vendimit Sh.02.Nr.3749 të datës 11.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Kamenicës në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21/04/2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.237/2022 e datës 16.03.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i sistemuar në vendin e punës "Përgjegjës i Sektorit për Rini", me datë 14.03.2022 me Rekomandim numër 1964220 të Postës së Kosovës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 16.03.2022 me numër protokolli 1405/2022 të regjistruar me numër A.nr.237/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Sh.02.Nr.3749 të datës 11.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Kamenicës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 16.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa e datës 20.01.2022; Plotësimi dhe ndryshimi i kërkesës së datës 20.01.2022; Vendimi i datës 11.02.2022 i Komisionit Disiplinor; Kërkesa e datës 22.11.2021 për aprovim të pushimit pa pagesë; Kërkesa për pushim e datës 02.12.2021, 30.11.2021, 08.08.2019 dhe e datës 20.11.2020.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi është i sistemuar në vendin e punës "Përgjegjës i Sektorit për Rini".

Ankuesi me datë 31.01.2022 me numër 2523 bënë plotësim ndryshimin e kërkesës me nr.1892 të datës 20.01.2022 për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkak të shkeljes disiplinore mos vijim në punë ose mungesa të paarsyeshme.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Kamenicës me datë 11.02.2022 merr vendimin me numër 01/2022 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar kërkesa me numër 1892 e datës 20.01.2022 e parashtruar nga UD Drejtoresha e DKRS-së znj. e plotësuar me kërkesën me numër 2523 e datës 31.03.2022 për inicimin e procedurës disiplinore ndaj shërbyesit civil i sistemuar në punë "Zyrtar për Rini", lidhur me pretendimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda disiplinore nga neni 46 paragrafi 3.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 16.03.2022, pretendon që të obligohet Komisioni Disiplinor që të rishqyrtoj çështjen, administroj provat dhe të merr vendim konform normave ligjore dhe provave të administruar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..."*, Kolegji vlerëson se me vendimet e kundërshtuara me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses lidhur me marrëdhënien e saj të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.237/2022 e datës 16.03.2022, e parashtruar nga ankuesi Bajram Mavriqi është e palejueshme.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.237/2022 datë 21.04.2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunes së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.